



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E SHTATË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.09.2022 (e Enjte)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, znj.Liridona Bislimi, z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkryetar, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të KPF-së! Këtë mbledhje kemi një volum më të madh të pikave. Me kohe e keni marr materialin. Tani para se me hi në rend dite hapi diskutimi nëse keni diçka.

z.Ilir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë vetëm dëshiroj që në emër të kryesisë së klubit KF “Vllaznia”, tu i ditë vështirësitë që i kemi pas ne këtë fillim të sezonës, e falënderoj kryetarin e komunës, drejtorin e kulturës dhe drejtorin e financave, të cilët ne mënyrë ekspeditive kanë bë transferin e subvencioneve dhe kjo është një ndër arsytet që kemi fillu garat.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Ilir! Unë në emër të krejtve ju urojmë suksese klubit. Ishalla vetëm përpara dhe na gëzoni me suksese. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2023-2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjobë për vitin 2023.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.
5. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Klokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunitat e Klokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.
c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Klokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën e kadastrale ne Viti, Radivojc dhe Sllatinë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit, për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitë drejtor, zv drejtor të shkollave fillore-mesme dhe çerdheve të Fëmijëve të Komunës së Vitisë.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, me Nr. 01-110/05-790 të datës 01.08.2022.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen “qytetarë nderi” i Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z. Alice P. Albright.
10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e Obeliskut për z. Madeleine Albright
11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit paraprak me nr. 01-110/05-477 të datës 04.05.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë.
12. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft Strategjinë e Zhvillimit Lokal 2022-2026.
13. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me datën 31.12.2021.
14. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2021.
15. Propozim për shqyrtim dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me participim.
16. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik Projekt Planin e Zhvillimit Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030.

Hapi diskutim tek rendi i ditës:

z.Naim Pira, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Meqenëse e di që sot keni mjaft pika të rendit të ditës, po unë kam një propozim vendim nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, meqenëse kemi atë formën e participimit dhe formën e projekteve që e kemi dhënë për bujqësi me ligjin e ri për buxhet, projektet të cilët kane participim nga ana e donatorëve, për mu hap një kod i ri duhet me kalu ne kuvend komunal. Unë po e shfrytëzoj rastin me e falenderu edhe sekretarin, Fatlumin, i cili ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe ka komunikuar me ministri na ka sugjeru formën si me bë. Kjo formë nga ky vit kërkohet, andaj para juve paraqes këtë propozim vendim për krijimin e kodeve të rinj për projektet me participim, në mënyrë që të behet pagesa e subvencionit. Operatori kërkoj me mirëkuptim, që të hyn në rend dite ky propozim vendim.

z.Visar Demiri, drejtori i Urbanizmit: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë kam një kërkesë, me mirëkuptimin e juaj që në rend ditë të futet edhe një pikë, pasi që kemi marr pëlqimin nga ana e Ministrisë, andaj kërkoj që propozim vendimin për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt Planin e Zhvillimit Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030, që të fillojmë debatin me publikun.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim: a jeni pro rendit të ditës me dy pikat shtesë që u prezantuan nga drejtorët? Ju lutem me ngritje të dorës! Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës:

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2023-2025

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Përshëndetje për të gjithë! projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2023-2025, është përgatitur në bazë të qarkores së parë buxhetore, bazë KAB-it komunal dhe krijimit të përgatitjes së draft projekt buxhetit komunal 2023-2025, ndërsa qarkorja e dytë buxhetore 2023/2 I kemi bërë kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, duke përfshi shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallrave dhe shpenzimeve komunale, subvencione për transfere dhe investime kapitale për këto vite. Plan buxheti për 2023, 2024 dhe 2025 në vitin 2023, buxheti do të jetë në vlerë totale prej 14 milion 996 mijë e 357 euro, duke ndarë në kategori ekonomike, pagat dhe shtesat do të jenë 7 milion e 609 mijë e 386 euro apo në përqindje marrin pjesë në buxhetin e përgjithshëm prej 50.74%; mallrat dhe shërbimet 2 milion e 432 mijë e 766 euro, apo në përqindje 16.22%; shpenzimet komunale 325 mijë euro apo 2.17%; subvencionet dhe transferet marrin pjesë me 3.80% apo 570 mijë euro, shpenzimet kapitale janë në vlerë prej 4 milion e 59 mijë e 205 euro apo 27.07%; shuma e grandit qeveritarë në këtë planë buxhet është 13 milion e 943 mijë e 538 euro; ndërsa të hyrat vetanake planifikohen të inkasohen në vlerë prej 1 milion e 52 mi 819 euro. Diferenca në vitin 2022 në buxhetin e përgjithshëm është 1 milion 926 mijë e 862 euro, apo 40.74%. Për vitin 2023 buxheti në kategori ekonomike, kategoria e pagave dhe shtesave në total si e thashë 7 milion e 609 mijë e 386 euro, administrata merr pjesë me 1 milion e 241 e 830 euro apo 16.32%, arsimi dhe shkenca 5 milion e 245 mijë e 303 euro apo 68.93%, shëndetësia dhe mirëqenia sociale 1 milion e 65 mijë e 355 euro apo 14%; shërbime sociale 57 mijë e 150 euro apo 0.75% , kategoria mallra dhe shërbime në total prej 2 milion e 432 mijë e 766 euro; administratë në këtë buxhet merr pjesë prej 1 milion e 281 mijë euro apo 51.93%; arsimi dhe shkenca 433 mijë euro; qendra sociale 711 mijë e 666 euro apo 29.37%; në kalimin e mallrave dhe shërbimeve të grandit qeveritar merr pjesë me 2 milion e 243 mijë e 766 euro. Në faqen 11 e keni më të përmbledhur, shpërndarja e buxhetit sipas linjave dhe grandeve të gjitha janë ato shifra të cilat I thashë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtor, faleminderit shumë, zakonisht pjesa e buxhetit është çështja më e rëndësishme e punës së kuvendit dhe orientimit të buxhetit dhe qeverisë komunale dhe në pjesën e buxhetit pjesë që e kemi marrë, pjesa komunal, ato janë pjesë që janë të parapamë për shpenzimet që bëhen dhe zakonisht shpenzimet më shumë lidhen te çështja e investimeve kapitale, sepse aty shihet edhe drejt për drejt te qytetari se cilat investime do të bëhen kësaj radhe, domethënë dallon prej buxhetit e vitit të kalum, se janë të specifikume një pjesë e madhe e projekteve që është bë një mundësi më e mirë që të shihet edhe në buxhet, ndërsa te pjesa e përgjithshme, nëse keni ndonjë gjë është çështje tjetër.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Te subvencionet që janë afër 210 mijë euro, Zyra e Kryetarit 120 mijë euro; kulturë, rini dhe sport 100 mijë euro, bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural 300 mijë dhe shërbime sociale 50 mijë euro. Në total prej 570 mijë euro për vitin e ardhshëm janë këto për subvencione.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit shumë drejtorë! Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Edhe njëherë, faleminderit kryesues! Me thanë të drejtën krejt këtë material se kam lexu përveç kësaj faqes së fundit që është shumë me rëndësi, se të gjithë qytetarët e presin këtë që kanë me u bë këto investime. E ceke edhe ti, domethënë janë shumë projekte që kanë me u bartë në vitin 2023. Unë kisha kërkun prej nënkryetarit, është rregullimi i kanaleve dhe proçkave. Unë mendoj që duhet me u kanë pak një shumë më e madhe, për arsye se ankesën e parë të dëgjimit publik që e kemi mbajt në Pozheran, domethënë është bë e papërballueshme jeta, sidomos në familjet që e kemi kanalet për rreth shtëpive, edhe pse është i shtimë kanalizimi. Nuk e di ka vjen ai ujë, nuk e di ka vjen ajo erë, domethënë është bë e papërballueshme jetesa aty. Mendoj që duhet me kanë një shifër më e madhe, se përveç Pozheranit ka me pas edhe fshatra të tjerë. Këtë problem, është domethënë “Lagjja Demiri”, është edhe drejtori këtu, e dinë që edhe banorët aty që rrinë për rrethi, e ka të njëjtin shqetësim si unë qysh e kamë. Dashta me pyet këtu te punimet, te ujësjellësi, këto 40 mijë euro. Nënkyetar, që janë nda a është ajo pjesa ku e kemi nda me kuvend për rritje të kapacitetit të ujit apo është diçka tjetër, mu dukë punë e mirë lidhja e 3 fshatrave që ka me u bë asfaltimi i rrugës, edhe pse neve Pozheranit

shumë pak na hinë në punë po bëhet lidhja me Ramjan dhe Sllatinë, po një punë e mirë. Çka më ra në sy diçka mu në krejt qëta shumë, Devaja kish hi këtu, Devajë, Zhiti, Devajë Radivojcë Devaj atje nuk kishë lanë vend pa u lidhë nuk kam diçka tjetër më shkojë në sy kjo në 5/6 vende e pashë Devaja, trotuaret Devaja rrugë Devaja ujësjellës kur Pozherani ka nevojë për trotuare prej 2020 na ka thënë ish drejtori i financave Ibrahim Rama që janë në projekt edhe nuk janë të krye hala.

znj.Liridona Bislimi: Faleminderit Kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Faleminderit edhe drejtorit për prezencën e planit buxhetor, atëherë duke e marrë parasysh rendësinë e këtij dokumenti që e kemi para vetes, duke e marrë parasysh që edhe pjesa dërmuese e diskutimit bëhet në nivelin e mbledhjes së kuvendit, unë dashta në vija të trasha dhe në pika të shkurtra ta bëjë një diskutim, i cili ka qenë paraprakisht i përsëritur edhe viteve të kaluara, ashtu si Lëvizje Vetëvendosje siç e kemi cekur këtë dokument që e kemi, ka disa ndryshime të cilat i përmendi edhe kolegu para meje, për të cilat ju përgëzoj, por sinqerisht përsëri prapë nëse ne e marrim këtë dokument edhe qytetarët e kuptojnë që ne si përfaqësues të tyre kemi njohuri mbi shpërndarjen e buxhetit dhe ju intereson ta dinë se ku do të shpërndahet paraja publike, prapë se prapë drejtorë ne nuk kemi përgjigje konkrete në disa vija buxhetore. Ta zëmë përshembull te faqja e fundit, që e përmendi edhe Iliri, participimi i projekteve me donatorë, asfaltimi i rrugëve rurale, rregullimi i kanalizimeve, rregullimi i rrugëve me zhavorr, ndriçim i trotuareve publike, rregullimi i hapësirave gjelbëruese, rregullimi i fushave sportive e të gjitha këto, kanalizimi dhe prrockave janë në vija të trasha, domethënë në vija të përgjithshme, ta zëmë përshembull nëse vjen një banorë i fshatit Pozheran, që e përmendi Iliri apo prej fshatrave tjera. Edhe nëse më pyet, nëse do të bëhet rregullimi i fushës sportive, atëherë nuk kam përgjigje konkrete, se ku do të destinohen këto mjete, andaj kjo kërkesë ka qenë vazhdimisht prej subjektit tonë, prej Lëvizjes Vetëvendosje. Pra, është viti i 5-të që ne bëjmë kërkesa të tilla, edhe mendoj që është mirë ta kemi një specifikim. Vazhdimisht kemi pas ankesa rreth materialit, rreth shpenzimeve, po besoj që në ditë të sodit kemi zgjedhje, i kemi e-maillet zyrtare edhe kemi mundësi përmes këtyre e-maileve. Jemi një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve në institucione. Kuvendi komunal është institucioni më i rëndësishëm edhe ne besoj që do të duhet t'i kishim pasur të paktën nëpër e-mailat zyrtare specifikimet të tilla. Unë e di që përgjigjen që do të ma jepni do të jetë që, Ministria e Financave ka pranuar këtë buxhet qeshtu dhe është në rregull që e ka pranuar, mirëpo unë po flasë si një qytetarë e Komunës së Vitisë. Besoj që do të kishte qenë në rregull që ta kishim pas një specifikim më të mirë. Është përgjigja më e thjeshtë që kishim mund të ja japim një qytetari. Të më kishin pyet mua, pika e 3, rregullimi i kanalizimeve. Cilët fshatra në Komunën e Vitisë do të ketë rregullim të kanalizimeve? Unë kam kërkuar 4 vite të afatit të kaluar edhe nuk e kam pas të specifikum asnjëherë këtë gjë, vetëm pas 3 viteve ta zëmë, nëse keni vendosur fshatin Devaj ose Dobolldëh të bëhet aty për aty rregullimi i kanalizimit, unë absolutisht nuk e di në fshatin tim Drobesh se çka do të ndodhë në këto 4 vitet e ardhshme kundër faktit që e kam përmend që, kemi qenë neper dëgjime buxhetore, kemi qenë nëpër trajnime të ndryshme, kemi bërë kërkesa të protokollume, po prapë se prapë ato kërkesa që i kanë nevojat banorët nëpër lagje të ndryshme, ta zëmë shembull qoftë për një ndriçim publik. Unë si përfaqësuese e tyre, absolut nuk e kam të qartë se çka do të ndodhë në fshatin tim, apo në fshatrat tjerë. Në rregull, letra nuk po doni me shpenzu, po përmes e-mailit e ki shumë të lehtë. Faleminderit shumë!

z.Jakup Demiri: Punimet në ujësjellës në rrjetin e kapacitetit të ujit në Letnicë është 40 mijë euro, nuk është më shumë dhe a ka ndonjë shumë më të madhe apo vetëm kjo është, a është vetëm për Letnicë apo në përgjegjësi për ujësjellësin në Komunën e Vitisë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Faleminderit Kryesues! Më lejoni të ju përshëndes të gjithëve pa dallime, megjithatë më vjen mirë që është një draft buxhet, i cili më i specifikum se vitet tjera të cilët e kanë edhe këshilltarët edhe kryesuesi, po megjithatë punët të cilët po bëhen është problematikë me i specifikum të gjitha me rrugë 100 metra, me rrugë 70 metra. Ne jemi shku kësaj radhe rrugë të cilat janë më shuma më të mëdhaja me i specifikum, ndërsa këto tjerat janë si zëra buxhetore. Unë vetëm një çështje po ndalna, te Iliri. Tani besoj më mirëkupton edhe Liridona, është me rëndësi që kemi zë buxhetor për rregullim të kanaleve dhe prrockave në rast se e keni parë prej ardhjes, domethënë viti i 9 rregullisht e kemi parapa dhe e keni pa ndoshta

të reshurat e fundit, pasojat në Gjakovë apo ndokund tjetër dhe i keni parë sa e ka pas efektin e vetë. Në Viti nuk jemi ballafaqu me ato, tashmë prej kësaj faze të cilët ju do të jeni ata të cilët e aprovoni buxhetin, se e keni në dorë të juve, vjen faza e planifikimit të rrugëve, rrugicave dhe unë konsideroj që nuk ka përfaqësues të fshatit, kryetar, të cilët nuk merret mendimi i tij kur është fjala të rrugët e vogla dhe kanalet, aty merret mendimi i tij dhe do të futen me emërtim, se pa emërtim nuk mund me i shpall edhe në tender, prandaj këtë çështje duhet me pas parasysh. Te çështja e ujit po u a bëj një njoftim, kam qenë një ditë më një takim të cilët po kemi telashe të mëdha, telashtet e ujit janë aq të mëdha që nuk është shumë lehtë me u zgjidhë. Kam bërë përpjekje të mëdha, të vazhdueshme, po ju them megjithatë unë e kam pas një parandjenjë që marrëveshja mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe CDI-së ka me qenë e dështuar, e kam pas bindjen dhe për mendimin tim edhe sot është e dështuar, dhe me takimin të cilin e kemi pas nënkryetarët e komunave, nivel Kosovës, së bashku me këshilltarët në kuadër të ministrisë janë dy këshilltarë që janë ekspertë të ujerave, pajtohen me këtë thënien time, ndoshta jo në këtë formë që po e them, por megjithatë pajtohen për shkak që unë e ngrita si çështje, se ka 2 muaj që bëjmë përpjekje me kryetarin, për shkak se ju keni qenë miratues të buxhetit që i kemi nda në 230 mijë euro në investime në ujë në vitin e kaluar dhe po rrezikohemi me na shku në suficit. Marrëveshjen të cilën e kemi nënshkru në vitin e kaluar, që e ka bë mbi 1 vjet, ata nuk janë kanë në gjendje me i implemetu që i kanë marrë detyrat edhe CDI edhe “Hidromorava” prandaj kanë qenë edhe takimet. A pe shifni, shumë shumë e vogël 40 mijë, po edhe këtë është problematikë me realizu, megjithatë po majm shpresa që kanë me marrë ma me seriozitet ngritjen e kësaj çështje edhe nga ana ime në takime edhe nga ana e kryetarit, edhe takimi i kryetarit me bordin e ri, i cili është zgjedhë, të cilët jemi obligu edhe marrëveshjen të cilët jemi përgatit edhe teknikisht me ja dërgu me thanë që ku e kemi pas marrëveshjen dhe po na u rrezikohen paret me shku në suficit. Tjetra që është shumë me rëndësi, nuk po mundemi me shku me lypë ne Kroaci, se ne kemi bë përpjekje dhe ju e dini që e keni shpallë atë zonë me interes të përgjithshëm me propozimin tonë, aty nuk po mundemi me gjetë pronarin se ai ka shku në Kroaci, e kemi porosit priftin tash, e kam porositë, ma ka pru Leonardi edhe një tjetër të cilin e njef, domethënë janë vështirësi gjatë rrugës të cilët me te vërtet edhe pa dashjen tonë, por të cilët nuk mundemi me i kry, por megjithatë vullneti ekziston edhe i joni, edhe i kuvendit, edhe i juvi, por na paraqiten vështirësi me të cilët kemi me bë përpjekje maksimale me i rregullu. Duhet ta pranojmë që edhe sipas këshilltarit ndërministrorë që është për ujëra, ka thënë po e çmoj vullnetin e juve si Viti, por mos mendoni që kemi me bë zgjidhje të frikshme kështu ta quaj për Komunën e Vitisë, e kanë edhe ata të kjartë, tash mu nuk më banë përshtypje, kështu ishte diskutimi im, du me ja u thanë kështu bukfalisht. Ju e di se i merrni raportet e CDI-së, që thotë se, Komunën e Vitisë e kom përfshi 70% me gypa, po unë po themë që Komuna e Vitisë nuk ka 20% a 30% ujë. Unë e konsideroj që ujë kanë atëherë kur qytetarët në mëngjes e përdorin, edhe për larje edhe për pirje, edhe ujë të përdorshëm. Edhe Perandoria Turke e ka lënë në këtë formë, e kam thënë shumë ari nëpër tokë, gjithë kanë grapu, po nuk kanë mujtë më gjete, prandaj qëto gypat e CDI-së i cilësoj qështu, por megjithatë ne nuk e kemi qare pa e pas një kod, se ishalla donë Zoti dhe shkon në aspekt pozitiv dhe njerëzit e kanë vullnetin e mirë dhe e qojnë këtë çështje. Ne e kemi patjetër me rreziku me e shti, se për çështjen për nuk i kemi punët mirë. Çka është me rëndësi, sipas eksperteve, thojnë nuk e kemi mirë edhe në burime nuk jemi mirë, të cilët ata janë më ekspert se ne i dinë edhe këto çështje. Liridonë, nuk është çështja të cilën e thave, që përgjigjen e di se ministria pranon, jo, këtë ta kesh të kjartë. Tash kur fillojmë me i planifiku, do të pyeten edhe kryetarët e këshillave të fshatit dhe ato kërkesat të cilat janë që i konsiderojnë ata elementare, gjithherë në përputhje me dy programe, e thamë vazhdimisht se e dinë edhe ti ata, se pe shef që edhe pushteti nivel qendror se si shkon programi i Kurtit. Dilemë nuk ka se ai i ka fitu zgjedhjet, ashtu shkon edhe në komunën e Sokolit, në këtë rast edhe i kryesuesit, për shkak se janë në koalicion dhe duhet me shku ai, por megjithatë ato të cilët janë me domosdoshmëri për qytetarët nuk ka problematikë, duhet me u kry.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Unë kisha dashtë te kodet e përgjithshme. Liridonë, këto janë pjesë edhe kontratë që e kemi lidhë, për këtë kanë hi si kode të përgjithshme, për me i përmbush kontratat që i kemi lidhë, përndryshe sigurona dhe po e marrë përsipër qëtu që kontrata që i kemi lidhë, të rrugës rurale, të gjitha që janë të përfshimë, rrugët, kanalizimet, ujësjellësit te Zyra e Prokurimit, do të bëhen publike, ndërsa te Letnica,

Jakup të tregoj nënkryetari, kena pare tash, e kemi lanë hapur për vitin e ardhshëm me shpresë që mujna me bë zgjidhje.

z.Jakup Demiri: Për faktin që para dy viteve kur e përmendet që e kishit draft buxhetin e kishit paraparë vetëm 30 mijë euro, edhe ne patëm bë shumë bujë aty, ndërsa vitin e kaluar në vit zgjedhor ishin diku rreth 230 mijë euro të paraparë, ndërsa për këtë vit ishin edhe më shumë, tash na del 40 mijë euro.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: 40 mijë euro i ki për shtim të kapacitetit edhe i ki dy ujësjellës të tjerë që e kapin atë vlerë.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Kjo është vetëm shtim i kapacitetit dhe për krejt territorin që e kap rezervari.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Si kod i përgjithshëm i ki 40 mijë në qatë kontest i ki të specifikume edhe dy lokalitete te cilët do të kenë ujësjellës. Mos harroni që i kemi edhe 230 mijë pa hargju.

z.Illir Zuka: Nënkryetar, unë krejt çka e kuptova kjo është për me u kanë një kodë buxhetor. Në qoftë se punohet diçka, përndryshe nuk paska diçka të parapamë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Megjithatë, me “Hidromoravë” nuk i kemi punët mirë, se është ndërru drejtori, është ndërru bordi, nuk jemi tu pas me kënd me bisedu, ashtu është gjendja.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje të dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjobë për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E kemi pas edhe në diskutim publik, e kemi përcjell prej kuvendit në seancën e mëhershme, miratimi i buxhetit duhet të jetë edhe me rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Është rregullore që çdo vit miratohet krahas buxhetit. Urdhëro drejtorë, nëse ka ndryshim prej asaj pjesës.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Ka ndryshim te Drejtoria e Shërbimeve Publike. Vetëm këtu është ndryshimi. Ju e dini që taksa për biznese është e hequr qysh moti, tek propozim ndryshimi që e ka bë drejtoria, është neni 12, pika 1.4, shfrytëzimi i hapësirave publike pranë ndërtesave për aktivitete biznesi, kafiteri, restaurant etj, si nga zona, domethënë është ndarë qekjo lëvizje, është kanë një zonë dhe është nda në 4 zona. Zona e parë është 2 euro metra katrorë për muaj, zona e dytë 1.70 euro për muaj, zona e tretë 1.50 euro për muaj dhe zona e katërt 1.20 për muaj, ku përfshihen të gjithë fshatrat e Komunës se Vitisë. Neni 13, pika 3.16, pika 1, vendosja e shtyllave elektrike në prona publike do të kushtojë 30 euro, neni 40 për dënime, kundërvajtje për persona fizik dhe juridik me dënime me gjobë për shkelje të depozitave të rregullores mbi taksa dhe tarifa si në vijim, neni 40, pika 1, me gjobë prej 300 deri 800 euro dënohen për kundërvajtje personi fizik, ndërsa 1 mijë euro dënimi 600 euro do të dënohet personi juridik, nëse vepron në kundërshtim me nenin 12, pika 1.1, pika a, b, c, d të ndryshimet kemi neni 40, pika 2, me gjobë 40 deri 60 euro, personi fizikë ose personat qe ushtrojnë personat individual, ndërsa personat juridik 110 deri 200 euro që veprojnë në kundërshtim me nenet. Do të hiqet pika 40.3 dhe 40.4 të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Ky është ndryshimi që e ka propozu Drejtoria për Zhvillime Publike.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit drejtorë! Besoj që ndryshimet që i ka propozu janë konfrom rregulloreve dhe ligjeve në fuqi. 99% është që disa vitin që jemi tu e përcjell, të njëjtën nuk kemi pas ndryshim të tarifave, përpos tash që paskan ndryshu. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Planin e punës e kemi pa sot në kuvend. Po zhvillohen praktikatat e mëhershme, duke u bazuar edhe në pjesën e nevojave që shihen për vitet në vijim, bazuar edhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në pikat të cilat janë obligime ligjore të vinë në kuvend, konsultim edhe me komisionin për materialin edhe vërejtjet në diskutime publike, të cilat janë marrë. Është një planë për kuvend që parashihet për vitin në vijim, që janë parapa të mbahen seancat, pikat të cilat do të punohet kuvendi komunal për vitin 2022. Besoj materialin me kohë e kemi marrë, kjo nuk është që është fikse, sepse mund të vijë pika edhe kërkesa të grupeve të kryetarit, kryesuesit në bazë të nevojave, seancave të kuvendit të jashtëzakonshme. Nëse ka dikush, hapi debat për diskutim. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje të dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike

b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunitat e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike

c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tash ne, duke e pasur parasysh që Komuna e Kllokotit gjendet komplet në territorin e Komunës së Vitisë, edhe Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal, po edhe është e obligueshme, ndonëse është komplet në territorin e komunës sonë, sepse janë të varura të dy komunat që duhet të kryhen projektet e përbashkëta.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Unë besoj që e ka atë pjesën dërmuese të cilët duhet me thanë edhe në aspekt të performances edhe në aspekt territorit janë dy çështje të cilët ndoshta do të jenë në të mirën e qytetarëve që të jetë një marrëveshje e tillë. Ne kemi fillu konsultimet e para të cilat i kemi pas së bashku, që është pajtu edhe kryetari i Kllokotit. Ka shumë projekte të cilët ne i kemi realizu në territorin e tyre, ndoshta aty mundemi më përfitu edhe nga ana e asaj komune, e cila sidomos në ministrinë e linjës, të cilën e kanë për kthim, por megjithatë ajo që na shtyn neve është një kërkesë e jona për rregullimin e rrugës Viti-Kllokot, që prek në territorin e tyre, por duhet me pas një marrëveshje bashkëpunimi, se ne kemi hy edhe ashtu me potencu rrugën e Terpezes për Zhiti edhe rrugën Viti-Mogillë dhe Mogillë-Skifteraj rrugën, por megjithatë është mirë të jetë një marrëveshje e tillë për shkak të performances që komuna mund ta ketë, por edhe për shkak të bashkëpunimit të cilat mund të i ketë edhe anët e veta pozitive, unë do të ju lexoj se kjo është një pikë, por që ligji kërkon 3 propozim vendime të tjera, prandaj i kemi të paraqitura. Kësi praktika kemi pas edhe më herët.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtu te C, a është dashur të jetë autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të fillu konsultime me Komunën e Kllokotit apo me kryetarin e Komunës së Kllokotit?

znj.Fatbardha Emini, drejtoresha e arsimit: Nuk po e shofë që e kemi përfshi edhe arsimin, se ne atë ditë e kemi diskutu, edhe ashtu ju ofrojmë mbështetjen edhe në fushën e arsimit.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Duhet me shtypë, është çështja që edhe ta kemi të qartë, ne kemi kry shumë shërbime, se janë edhe qytetarë tanë ata që e tha edhe kryesuesi që, është edhe në territor tonë. Ju e dini edhe si është bërë edhe shërbime të zjarrfikësve. Ne kemi kry, por megjithatë pa marrëveshje nuk kemi kanë të evidetum që i kemi kry. Edhe çështjen e arsimit, që e tha drejtoresha, edhe çështjen aspektit shëndetësor, edhe shërbime juridike, tash kanë kërku, deri tash s'ka pas të inspeksionit.

znj.Fatbardha Emini, drejtoresha e arsimit: Atë ditë kur e kemi pas takimin, përpos që është kriter ligjor, nuk mundesh me i ofru shërbime një komunës, nëse nuk e ki këtë marrëveshje draftë mbi punën në kuvendë. Kjo është edhe performancë, po edhe është nismë për me fillu çdo partneritet me një komunë tjetër në aspekt territorial është një Komunë si e Ferizajit si e Klllokotit është njëjtë për neve, pavarësisht që ne kryejmë shërbime. Unë pikërisht kam dashtë me pas këtu edhe arsimin, për shkak se ne i ofrojmë shërbime. Po ashtu është edhe një marrëveshje te mësimdhënësit, që disa e plotësojnë normën atje. Ajo marrëveshje nuk e ka këtë bazën ligjore për me vazhdu, ne me pas ndonjë ndryshim eventual që na duhet me fresku në të ardhëm, domethënë kërkoj që të jetë pjesë edhe arsimit. Po ashtu edhe vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta që e kanë kërku edhe ofrimin edhe për çerdhe, domethënë nëse konkurren tash një fëmijë i Mogilës, ne nuk e kemi një marrëveshje qe duhet me i përfshi në nivel shkollor.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Veç edhe diçka të qartësojmë, te çështja e arsimit, apo mendon me i shti tashti në listë edhe personat me nevoja të veçanta.

znj.Fatbardha Emini, drejtoresha e arsimit: Jo, te pjesa e arsimit me një memorandum vetëm për fushën e arsimit mundemi me përpilu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Besoj që me rekomandimin që edhe pjesa e arsimit të hynë se është shumë e nevojshme, se edhe unë u befasova kur nuk e pashë, po thashë ndoshta paskan diskutu. I dimë do probleme që janë me këto marrëveshje të përbashkëta që i kemi diskutu deri tashë. Drejtoresh me çështjen e arsimit me drejtoreshën në Klllokot. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në Zonën e Kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë

znj.Majlinda Ostroglava, Drejtorja për pronë, Kadastër dhe Gjeodezi: Faleminderit Kryesues! Me këtë propozim është kërkesë për kthimin e pronave të cilat janë në interes të përgjithshëm. Kjo kërkesë është bërë edhe më herët. Ne ju kemi drejtu, AKP-ja na ka kërku me i shpallë këto zona për interes, pastaj me vazhdu me procedurat tjera. Domethënia këtu janë të përfshimë këto zona që janë, nuk ka shumë ndryshime edhe më herët që janë kanë. Ju i keni materialin, që doni i lexoj. Pak a shumë janë Varrezat e Dëshmorëve, tregu i gjelbër, të cilat janë parapa, eshë shkolla “Dëshmoret e Kombit”, parku Sllatina e Epërme, është objekti përball policisë, janë varrezat e fshatit Radivojcë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Drejtoreshë! Është një pikë mesa e di unë, çdo 4 vite e kemi përsërit. Janë pjesa e tokave dhe pronave që janë në menaxhim të AKP-së, që komuna është tu i shfrytëzu. Nëse nuk i shpallim ne në zonë për interes, ata dalin në shitje për me ndalu shitjen. Ne kemi provu çdo 3-4 vite kemi shpallë zonë për interes dhe ato nuk dalin në shitje përderisa është interesi i komunës dhe ne e kemi përsëritë dhe e përsëritmi të njëjtën. Ka qenë edhe një nismë me herët kur ne e kemi propozu përmes kuvendit, kemi dalë ne do parcela i kemi propozu AKP-së që me i ba ndryshim ndërrim, mirëpo nuk e ka bë, e tash ndoshta është bë mundësia që t’i kthemi këto në prona komunale.

z.Illir Zuka: A ka mundësi atë shkresën me na pru drejtorja që e ka kthy APK-ja, që e ka lutë me qitë zonë për interes në Komunën e Vitisë, se po më duket që veç po bina pika edhe po dalim keq si kuvend.

znj.Majlinda Ostroglava, Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë: Illir, tash është qëllimi, domethënë kërkesa ka qenë mi rikthy se kanë fillu disa komuna, kjo është veç procedurë, duhet me i shpall zonë për interes, pastaj vendimi i ligjshmërisë me verifiku.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E para është që, në momentin që e shpallim zonë në interes nuk del në shitje. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me te gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit, për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat drejtor, zëvendës drejtor të shkollave fillore-mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë

znj.Fatbardha Emini, drejtoresha e Arsimit: Faleminderit fillimisht, ju përsërites edhe një herë! Është një procedurë që duhet me ndjekë në bazë të udhëzimit administrativ, gjegjësisht Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit me Nr.151 2020, ku në nenin 6 kërkohet një komision përzgjedhës që propozohet nga Drejtoria e Arsimit, dy anëtarë duhet të jenë të komunës, të cilët propozohen nga DKA-ja dhe miratohen në Kuvendin Komunal të Vitisë. Është një procedurë që duhet me ndjekë në bazë të këtij udhëzimit, ndoshta atëherë kemi pas reagu, sepse më herët ka qenë kryetari po ka edhe që se kuptojnë që ka edhe dy organet që i ka komuna po të njëjtin jemi tu e zbatu këtë udhëzim administrativ në rast se mundet me u anku dikush mundet me ta prishë konkursin, për shkak që nuk e ke kalu komisionin përmes organit të kuvendit komunal, kështu shumë kuart, **0:52:07.2**, nuk kam diçka tjetër, vetëm kërkoj që të miratohet, është procedurë që në rast të paraqitjes së nevojave të vitit shkollorë të kemi zgjedhje të ndonjë drejtori të institucioni arsimor, atëherë komisionin ta kemi në bazë të udhëzimit administrativ që kërkohet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Drejtoreshë! Ne kemi pas edhe më herët, domethënë për komisionin. Komisioni është 1 vjeçar dhe gjatë një viti nëse ka konkurse për drejtorë ose zëvendësdrejtorë, është i njëjti komisioni që kryhet, procedura është ligjore, kjo është e obligueshme që kuvendit t'i ketë këto. A ka dikush me diskutu? A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, me Nr. 01-110/05-790 të datës 01.08.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë sa e kuptova është prapë kjo pika te barnatorja te QKMF-ja, që kemi marr ne vendimin, domethënë që dy seanca e kemi pas një herë, e kemi bë 3 vite, një herë 5 vite, tash prapë na ka ardh që kjo 5 vite është e shkurt, domethënë me zgjatë. Mu më ka ardh si propozim prej kryetarit, besoj që nënkryetari na jep tash një sqarim për këtë propozim që ka ardh.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Nga praktikat e mëhershme të cilat i kemi pas, domethënë i kemi pas 2 raste të propozim vendimin që kem pas edhe reagime të kandidateve të cilët janë të interesum me konkuru, se për te dyat kemi pas afatshmeri tjetër, ndërsa për këta kemi pas afatshmeri që kuvendi i ka vendos në seancën e kalume, prandaj kisha kërkua që të jetë një standardë dhe pikërisht për këtë e kemi sjell edhe këtë këtu kur është në pyetje prona e komunës është e njëjtë edhe nuk është mirë më pas ndryshime të afatshmerisë, për këtë arsye është ardhë edhe kjo këtu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit nënkryetari! Domethënë procedurat e dyta nuk kanë fillu.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Jo nuk kanë fillu.

z.Illir Zuka: Kryesues, unë personalisht po tregojë për veten, do ta votojë pro në qoftë se nuk bëhet pazar si në seancën e fundit në kuvend, që janë shty e kanë bë hajgare. A po e lajmë për 5 vite, 7 vite, hajde pe zgjatim dorën për 5 vite e u kthy në hajgare. Paraprakisht nëse nuk merret vendim domethënë a e kanë pru propozim vendimin ose e anulojmë krejt ose e kalojmë si propozim vendim si është këtu.

z.Ramadan Deliu: Unë z.Kryesues kam pas vërejtje edhe në ty, se kur të vjen një propozim për 13 vite, a sa ke, ti je i obligum me qit në votim e jo me i leju asamblistët me bë pazare.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, çdo propozim që më vjen mu prej kuvendit, unë e kam obligim ligjor me qitë në votim. Parimisht aty pat diskutime, unë jam mundu me çdo kusht që bile me nxjerr 10 vite, për këtë e kam lanë edhe debatin më shumë që me nxjerr një kompromis, se për 5 vite, se kerkush nuk hin për 3 vite 5 vite me bë një investim ose diçka. Për atë arsye unë nuk mundem me i a ndalu, se këshilltarët kanë të drejtë me fol, edhe mu më ka ardh keq që ai diskutim është bë në atë formë,

sepse një diskutim asi forme nuk na lejohet në kuvend, sepse duhet me u kanë pak më serioz në do gjena. Ti mundesh me dhanë një propozim si grup, mirëpo nuk mundesh me u qu me bë hajgare jo 3 vjet, jo 5 vjet, mirëpo unë nivelin e askujt nuk mundem me ndryshu, unë kështu i kam procedurat.

z.Jakup Demiri: Unë jam kundër kësaj që, për shkak se 13 vite janë shumë, edhe e dimë qysh jepen këto, qysh janë dhanë edhe më herët, shumë është 13 vite për mu edhe si komuna jonë edhe të gjitha komunat me sistem demokratik 13 vite janë shumë, po ne të shkon në kuvend atje e diskutojmë.

z.Ramadan Deliu: Për 13 vite i merr komuna 112 mijë e 320 euro, ka 720 euro muaji, boll janë për komunë.

znj.Liridona Bislimi: Tu e marrë parasysh faktin si e thanë edhe parafolësit, domethënë 3 herë e kemi diskutu këtë pikë, edhe personi ose personat të cilët kanë pas interes për marrjen e këtij objekti nuk kanë mujt me u dakurdu. Unë besoj që edhe në këtë rast qysh e tha edhe kolegu Iliri, ne si kuvend komunal nuk është që kemi dalë serioz në atë aspekt, po besoj që personi në vetë faktin që na ka vendosë në këtë pozitë nuk është tregu shumë kredibil edhe ne në të njëjtën kohë çështjes së tij ja kemi dhuru një ndryshim shumë të madh prej 5 vite në 13 vite, unë mendoj që nuk ka qenë një taktik ose një hapë i mirë prej neve si institucion karshi personave që po flasim, të cilët kanë tregu interes. Po në rregull, ne e kemi këtu para nesh materialin, edhe besoj që në kuvend kemi me diskutu. Po shpresoj që në kuvend kemi me pas një diskutim serioz, për shkak që është një temë shumë e ndjeshme, edhe qysh e përmendi edhe kolegu, prapa saj është një investim begi i madh.

z.Ramadan Deliu: Pse nuk e keni caktu me pru në kuvend edhe me bë për 10 vite edhe votohet, e jo me bë pazar.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Çdo pikë që vjen në kuvendë ka drejtë me u diskutu edhe me pru 10 vite, mundet me u qu dikush me thanë 11 vite. Kuvendi e ka mundësinë e diskutimit propozimin, munden me ma pru çdo propozim. Unë si kryesues kuvendi mundem me shti në rend dite, shembull kohën kur e kemi mundësinë dhe unë e bi në kuvend. Anëtarët e kuvendit kanë të drejt me diskutu çka do.

z.Illir Zuka: Kjo pikë ka kalu në kuvend për 5 vite, e keni dërgu në ministri, e ka marrë konfirmimin e ligjshmërisë

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Jo nuk e kemi dergu hiq, veç ta kemi të kjart, në momentin kur e ke shpallë ti herën e parë e ka marrë konfirmimin e ligjshmërisë.

z.Illir Zuka: Herën e parë?

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Po

z.Illir Zuka: Për herën e dytë unë jam duke e bërë pyetjen.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Edhe herën e dytë e ka marrë.

z.Illir Zuka: Në momentin që e ka marrë, ju është dashtë me qitë në ankand publik, nëse nuk konkurron kërkush ju e merrni pronën. Unë tregova, vetëm më ka pengu sjellja e asaj dite, për ndryshe unë jam pro.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Pjesa dërmuese ka qenë në kuvend kur ne i kemi dhënë dy, i kemi dhanë edhe arenën edhe këta te pishat kemi përdor standardë tjetër. Nuk është mirë ata të cilët i marrin, nuk është mirë kuvendi me pas kësi standardi, se prona është komunës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk e di a ka pas nevojë me pas anulim të atij vendimi.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Jo nuk ka nevojë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen “qytetarë nderi” i Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z. Alice P. Albright

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Bëhet fjalë për vajzën e Madeleine Albright. Ju e dini se çfarë ka bërë ajo për çështjen e Kosovës, në këtë rast kjo është edhe drejtoreshë e MCC-së. Komuna e Vitisë është një ndër komunat e para përfutuese e MCC, i keni pa edhe ndërtesat të cilat janë në përfundim e sipër, është një kontratë që është në mes komunës, dhe mendoj që e kanë një shumë simbolike për rregullimin e saj. Kjo ka shprehë gadishmërinë me vizitu Komunën e Vitisë, që konsideroj që na bënë nder edhe neve si ekzekutiv, edhe juve si kuvend, prandaj në vazhden e personaliteteve te cilët një praktik të tillë e kemi ndjek edhe më herët, e

që kemi konsideru personalitete që kanë rëndësi për Komunën e Vitisë, ta shpallim qytetar nderi propozimin. Është para jush, ju jeni ata të cilën duhet ta vendosni.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit nënkryetar! Zakonisht kur kemi bërë ndonjë procedurë e kemi pas edhe biografi me i qit, se parimisht ne e dimë se qëto informata i kemi, po për shkak të procedurës, po për në kuvend besoj që bëhet.

A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës. Të gjithë janë pro kundër nuk ka abstenim nuk ka me te gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e Obeliskut për z.Madeleine Albright

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Kjo vendosje do të bëhet me rastin e vizitës së zonjës, vajzës së Madeleine Albright. Ne do t'i bëjmë edhe një obeliskë për kontributin të cilin e ka dhënë për çlirimin e Republikës së Kosovës me partnerët e koalicionit. Kemi bisedu edhe jemi përcaktua për lokacionin, po ke pak problematike për shkak të pronës, andaj sot po e sjellim këtu para jush që ta miratoni. Unë nuk do të flasë për figurën e saj, për shkak se ju e dini edhe vetë lokacioni është para objektit të Zyra e Kryetarit. Kryesuesi e tha një çështje shumë me rëndësi, megjithatë janë disa çështje të cilat nuk varen prej kryetarit e prej neve, po po varen prej dikujt tjetër. Ajo një kohë bukur të madhe ka hezitu a do të vjen a nuk do të vjen, dhe në momentin kur ka qenë në takimin e fundit të MCC-së i kanë tregu kryetarit që ajo do të vjen dhe është marrë iniciativa. Besoj, ne juristat e dimë që ka shkelje, po jo shkelje esenciale.

z.Illir Zuka: Keni pas hapësirë veç edhe 1 meter më brenda se mu dukë që është ndërtu në trotuar.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të njëmbëdhjetë rendit të ditës kemi:

11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit paraprak me nr. 01-110/05-477 të datës 04.05.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse ju kujtohet, ne e kemi pas miratu shpalljen në interes të përgjithshëm edhe ne Letnicë atë pronën, edhe këto parcelat që janë për skajt rrugës Sllatinës, ku është bë zgjerimi rrugës, dhe asfaltimi që duhet bëhet, ndërsa parimisht është procedurë e njëjtë, për atë na kanë kthy që është e ligjshme, është fjala për këtë vendim, pasi që e ke kthy që nuk ka nevojë, ne kemi insistu me ta a duhet me u anulë a jo. Drejtoresha e ka marrë e i ka qu shkresa ministrisë, parimisht mos me thanë s'ka nevojë si vendim mos me met në fuqi dhe një vendim që nuk ka nevojë duhet me u shfuqizu mos me metë në fuqi, kjo është. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të dymbëdhjetë rendit të ditës kemi:

12. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft Strategjinë e Zhvillimit Lokal 2022-2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është një dokument që e ka paraqit Zyra e Zhvillimit dhe është një dokument që ka pas shumë material, pasi që është për diskutim publik, ju ka kërku materiali që të del në diskutim publik dhe ajo strategji e zhvillimit do të vjen në kuvend. Është fjala vetëm për diskutim publik. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të trembëdhjetë rendit të ditës kemi:

13. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me datën 31.12.2021.

z.Besnik Imeri, Drejtori I Financave: Duke u bazu në Ligjin për Zhvillimin e Financave Publike dhe përgjegjësi, Auditori Gjeneral ka auditu Komunën e Vitisë, pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2021-31.12.2022. Nga ky auditim auditori ka vënë në opinion të pamodifikuar këto pasqyra financiare. Bazë për këtë raport janë pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë për këtë vit, pra 2021, të cilat paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Sipas kontabilitetit dhe parasë së gatshme, konkluzioni i përgjithshëm i auditimit sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera me procesin e ekzekutimit të Buxhetit të Komunës së Vitisë kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që mbarojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Nga ky auditim kanë dalë 13 rekomandime, 9 prej tyre janë të reja, 3 të përsëritura dhe 1 pjesërisht e përsëritur. Çështja e 1 e gjetur është përfitimi i paligjshëm i tatim paguesve për zbritje, për vendbanim parësor. Çështja e 2-të është subvencionimi i përfituesve në kundërshtim me rregulloren komunale dhe rregulloren e financimit publik të OJQ-ve. Çështja e 3-të është mangësia dhe përmbylljen e procedurave të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratave. Çështja e 4-ër, vonesa në pagesa dhe faktura, obligimeve dhe shpenzimeve shtesë të procedurave përmbartimore. Çështja e 5-të, angazhimi i njohjeve ndërkombëtare për shërbime të veçanta. Çështja e 6-të, mangesimi i inspektimit i objekteve komunale. Çështja e 7-të, vlerësim i aplikacioneve për subvencione në kundërshtim me rregulloren. Çështja e 8, skadimi i sigurisë së tenderit para nënshkrimit të kontratës. Çështja e 9-të, regjistrimi i gabuar i pasurisë si investim në vijim. Çështja e 10, mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive. Çështja e 11-të, mungesa e veprimit për mbledhjen e llogarive të arketueshme. Çështja e 12-të, prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare dhe çështja e 13-të, mangësi në sistemin e auditimit të brendshëm. Unë kisha kalu edhe te plani i veprimit, i kemi në detaje në pikën tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse nuk ka për diskutim, a jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje të dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të katërbëdhjetë rendit të ditës kemi:

14. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2021

z.Besnik Imeri, Drejtori I Financave: Plani I veprimit është dorëzuar në afatin ligjorë të paraparë dhe në të gjitha çështjet jemi zotuar që të bëjmë atë që është e mundur për përmasimin e gjetjeve, përfitimi i paligjshëm i ngritjes për vendim parësor. Kemi marrë veprime për rianketim dhe rivlerësim të pronave, ku janë bë përlllogaritjet gabim. Subvencionimi i përfituesve në kundërshtim me rregulloren komunale, kjo dihet edhe janë 2 OJQ me nga 2 mijë euro të cilat nuk lejohen brenda 1 viti. Kjo ka ndodhë për shkak që llogaritja aktive për vitin 2021, llogaria nuk ka qenë aktive dhe pagesa ju është ba e 2020 ju është ba 2021. Kur llogaria është aktive dhe I ka ra që në të njëjtin vit pagesa është bërë 2 here, por vendimet kanë qenë të një viti paraprakë dhe nuk është gabimi te komuna. Vonesa në pagesat e fakturave, obligimeve, këto i kanë tekë mallrat dhe shërbimet të cilat kanë ardh faktuarat pas datës 25 nëntor, të cilat nuk mundemi ne me bë zotim të tyre.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht ajo pika e parë është ma shumë e diskutimit, sepse ato janë gjetjet që po diskutohen. Pika e dytë është plani juaj se si keni mi përmisu ato gjetje dhe këto ju duhet me I zbatu dhe me dalë ma mirë për vitin në vijim, ndërsa pika e diskutimit neve çka na intereson si kuvend janë gjetjet, sepse ajo është gjetje, ndërsa ky është plan që ti duhesh me zbatu që ma mos me pas gjetje.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Vitin e ardhshëm si të vinë ata hala pa hi me të auditu ti marrin qëto gjetjet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse nuk ka për diskutim, a jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të pesëmbëdhjetë rendit të ditës kemi:

15. Propozim për shqyrtim dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të rinj për projektet me participim

z.Naim Pira, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari: Unë veç po du me ju falënderu për mirëkuptimin që pat për me pru si pikë të rendit të ditës. Po tham edhe njëherë i ka ardh drejtorisë vërtet Zyrës së Financave në momentin pasi që është shkepë materiali dhe dashta me interes veç te ju tregojë që është be një gabim i vogël te shuma. Në vend të 17 mijë e 975 është shkru 17 mijë 795. Do të thotë me pas parasysh në kuvend e përmirësojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse nuk ka për diskutim, a jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Si pikë të gjashtëmbëdhjetë rendit të ditës kemi:

16. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik Projekt Planin e Zhvillimit Komunalë të komunës së Vitisë 2022-2030

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ka ardh prej ministrisë, na ka ardh rekomandimi që me dalë në diskutim publik, të ja hapim rrugën, të ja japim mundësinë që të del në diskutim. A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet. Faleminderit shumë!

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi**
